



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2324

NR. VENDIMI 2923



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Nr. 2324 Akti
Nr. 2923 vendimi

Date rregj.20.05.2021
04.11.2021

Date vendimi

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtar : LAZER SALLAKU

Asistuar nga sekretar gjyqësor **Rei Peçi**, me pjesmarrjen e prokurorit ***, sot me dt.04.11.2021, në Tiranë, mori në shqyrtim ne seancë gjyqësore publike çështjen penale, qe i perket:

I PANDEHUR: ***, ID. me nr. personal ***, i biri i *** dhe i ***, dtl. ***, lindur dhe banues ne ***, arsimi i larte, beqar, me gjendje gjyqesore i padenuar me pare, me kombesi e shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av. ***, zgjedhur me deklarim.

***, ID. me nr. personal ***, i biri i *** dhe i ***, dtl. ***, lindur dhe banues ne ***, arsimi i larte, beqar, me gjendje gjyqesore i padenuar me pare, me kombesi e shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av. ***, zgjedhur me deklarim.

AKUZUAR: Përkryerjen e vepres penale “Shkelje e te drejtave te pronesisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a/2 i Kodit Penal.

VIKTIMA: ***, me Nr. (NUIS) ***, regjistruar ne Q.K.B ne daten ***, me adrese ***, me administrator Z. ***, gjykuar ne mungese, perfaqesuar ne gjykim nga avokati ***, zgjedhur me autorizim nga administratorja e shoqerise.

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen me gjykim të shkurtuar, dëgjoi prokurorin e çështjes, i cili në diskutimet perfundimtare kerkoj:

Deklarimin fajtor te te pandehurit *** per vepren penale te “**Shkelje e te drejtave te pronesise industriale**”, parashikuar nga **neni 149/a/2 i Kodit Penal** dhe denimin e tij me *** lekë gjobë.

Deklarimin fajtor te te pandehurit *** per vepren penale te “**Shkelje e te drejtave te pronesise industriale**”, parashikuar nga **neni 149/a/2 i Kodit Penal** dhe denimin e tij me *** lekë gjobë.

Shpenzimet proceduriale te paguhen nga i pandehuri.

Mbrojttesi i te pandehurit * përfundimisht kërkoi:** Pafajesi.

I pandehuri * përfundimisht deklaroi:** Dakort me avokatin.

Mbrojttesi i te pandehurit * përfundimisht kërkoi:** Pafajesi.

I pandehuri * përfundimisht deklaroi:** Dakort me avokatin.

Mbrojttesi i viktimes se vepres penale përfundimisht deklaroi: Dakort me kerkesen e prokurorise.

Gjykata, pasi shqyrtoj çështjen në tërësi:

VEREN:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të pandehurve *** dhe *** akuzuar për vepren penale të “**Shkelje e te drejtave te pronesise industriale**”, parashikuar nga **neni 149/a/2 i Kodit Penal**.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur per gjykim bazuar ne nenin 69 te K.Pr.Penale, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kesaj çështje penale duhet te realizohet perpara kesaj gjykate.

Po keshtu kjo çështje ne baze te neneve 13 dhe 74 te K.Pr.Penale, është ne kompetencen lendore te kesaj gjykate, pasi vepra penale per te cilën janë proceduar të pandehurit gjykohet me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtar.

Persa i perket kompetences tokesore, ajo percaktohet shprehimisht ne nenin 76 te K.Pr.Penale ku citohet se: “*Kompetenca tokesore percaktohet, me rradhe, nga vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja*”. Persa me siper, perderisa vepra penale dyshohet se është kryer ne Tiranë, kompetente per nga territori është kjo gjykate.

Gjithashtu, Gjykata ne veshtrim te neneve 13,15,16,17,18 te K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojne shkaqe papajtueshmerie ose perjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundershtuar edhe nga palet pasi u prezantua perberja e trupit gjykues.

Gjykata konstaton se, në zbatim të nenit 332/c pika 3 të K.Pr.Penale nën titullin “Zhvillimi i seancës” të pandehurit kanë paraqitur në seancë paraprake kërkesë për gjykim të shkurtuar dhe në seancë gjyqësore të gjykimit të themelit, të pandehurit u shprehen se i qëndronin kësaj kërkesë.

Gjykata pasi e pranoi kerkesen, e zhvilloi gjykimin sipas kerkesave te nenit 405 te K.Pr.Penale, duke u bazuar në gjendjen që janë aktet.

Rrethanat e faktit.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se mbi bazen e kallezimit penal, te ardhur nga kompania ***, me date ***, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane, ka regjistruar proçedimin penal nr. *** te vitit ***, per vepren penale te “Shkelja e te drejtave te pronesisë industriale” parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal.

Me date ***, kompania ***, ka depozituar ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se pare Tirane nje kallezim. Ne kete kallezim penal, perfaqesuesja e kesaj shoqerie ka kallezuar se kjo kompani eshte person juridik shqiptar, licensuar nga *** për të ushtruar veprimtari ekskluzive audiovizive, ne funksion te ciles ushtron dhe veprimtari ne ndertimin e sistemeve te telekomunikacionit dhe transmetimeve audiovizive dhe riperseritjen e tyre ne çdo lloj transmetimi satelitor, tokensor, kabllor, IPTV, OTT, Internet TV.

Punonjesit e kesaj shoqerie, nepermjet monitorimit te transmetimeve te ndryshme ne internet, jane vene ne dijeni te nje aplikacioni te quajtur “****” dhe “****”, te cilet transmetonin tek persona te tjere ne menyre te paligjshme kanale televizive te platformes satelitore *** si dhe te ***. Ky transmetim kryhej nga keta persona ne mungese te nje marreveshje me Shoqerine “****” Sh.a dhe ***. Nga kerkimet e bera nga punonjesit e ketyre kompanive, ka rezultuar se ky Aplikacion nuk ishe i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe nuk dispononte asnje licence apo autorizim nga ana e Autoritetit te Mediave Audiovizive apo Autoritetit te Komunikimeve Elektronike e Postare ne Republikenn e Shqiperise.

Punonjesi i kompanise ***, ***, ka kryer nje pagese prej *** euro ne emer te shtetasve *** dhe ***, duke komunikuar me keta shtetas me portalin “****” dhe “****” dhe ka perfituar sherbimet e shoqerise ***dhe *** ne menyre te paligjshme.

Shetasja ***, ne cilesine e personit qe tregon rrethanat e hetimit, ka deklaruar se punon ne detyren e Drejtueses se Departamentit Ligjor ne shoqerine “****” sh.a. Shoqeria “****” Sh.a., eshte nje person juridik shqiptar, licensuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, per te ushtruar veprimtari ekskluzive audiovizive, ne funksion te ciles ushtron dhe veprimtari ne ndertimin e sistemeve te telekomunikacionit dhe transmetimeve audiovizive dhe riperseritjen e tyre ne cdo lloji transmetimi satelitor, tokensor, kabllor, IPTV, OTT, Internet TV, dhe televizoreve te tjere. Marka e produktit te kesaj shoqerie eshte e regjistruar dhe e mbrojtur nga legjislacioni ne fuqi. Nepermjet monitorimit dhe kontrollimit te transmetimeve te ndryshme ne internet, jane vene ne dijeni te nje aplikacioni “****”, i cili transmeton tek personat e trete ne menyre te paligjshme programet si kanale televizive te platformes satelitore “****” Sh.a. Ky person nepermjet aplikacionit dhe linkut <http://> ***, ushtron aktivitet te paligjshem dhe te pa licensuar duke kryer transmetimin e kaneleve *** ne kete link pa asnje te drejte transmetimi te dhene nga subjekti ***, i cili eshte prodhuesi i licensuar i ketyre programeve. Ky transmetim kryhet ne mungese te nje marreveshje me Shoqerine “****” Sh.a. dhe ne mungese te nje autorizimi per transmetimin e kanaleve televizive ne pronesi te ***. Ajo deklaroi se nga kerkimet qe kane bere ne lidhje me kete problem, ka rezultuar se ky aplikacion nuk eshte i licensuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive per transmetime programesh audiovizive dhe sigurisht keta persona qe disponojne kete link aplikacion, qe jane *** dhe ***, nuk jane te regjistruara ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe jane perfitues direkt te vlerave monetare nga kjo veprimtari e paligjshme. Ajo deklaroi se ky fakt eshte verifikuar, duke gjurmuar nje qytetar, i cili ka kryer pagesen nepermjet nje mandat dergese parash nepermjet ***, qe eshte ne shtetin Maqedonas. Me kete mandat pagese eshte marre shtetasi ***, ne numrin e llogarise ***. Sipas ketij mandati shenohet vlera *** euro, komisioni *** euro. Mbas kryerjes se pageses, ketij personi qe ka komunikuar me

shtetasin ***, eshte hapur linku [http:// ***](http://***), ne te cilin jane shfaqur kanalet dhe programet e shoqerise "****".

Shtetasi ***, ka deklaruar se punon ne detyren e Drejtorit Teknik ne shoqerine "****" sh.a. Gjate ushtrimit te kesaj detyre, nepermjet monitorimit dhe kontrollimit te transmetimeve te ndryshme ne internet, eshte vene ne dijeni te nje aplikacioni "****" dhe "****", i cili transmeton tek presonat e trete ne menyre te paligjshme programet si kanale televizive te platformes satelitore "****" Sh.a. Ai deklaroi se nga kerkimet qe kane bere ne lidhje me kete problem ka rezultuar se ky Aplikacion nuk eshte i licensuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive per transmetime programesh audiovizive dhe sigurisht, keta persona qe disponojne kete link aplikacion jane *** dhe *** dhe nuk jane te regjistruara ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe realizojne trasmetimin e paligjshem nepermjet aplikacionit te siperpermendur dhe perfitues direkt te vlerave monetare nga kjo veprimtari e paligjshme. Ai deklaroi se, kete fakt e kane verifikuar duke komunikuar nepermjet rrjeteve sociale dhe duke kryer pagesat dhe duke perfituar sherbimet perkatese pikerisht nga shtetasit *** dhe ***. Shtetasi ***, deklaroi se kete gjurmim e ka bere shefi i njesise antipirateri i shoqerise *** ***, i cili ka blere sherbimin nepermjet internetit nga portal *** dhe ka bere pagesen per kete ne sherbim nepermjet *** ne llogarine e shtetasve *** dhe ***. Kodi i mandat pageses eshte *** date ***. Pagesa eshte bere ne emer te shtetasit *** dhe terheqja e lekeve eshte bere nga shetasi ***.

Shtetasi *** ka deklaruar se punon ne detyren e *** ne shoqerine "****" sh.a. Ai deklaroi se nepermjet monitorimit dhe kontrollimit te transmetimeve te ndryshme ne internet, eshte vene ne dijeni te nje aplikacioni "****" dhe "****", i cili transmeton tek personat e trete ne menyre te paligjshme programet e platformes se shoqerise *** dhe ato te supersportit, gjithashtu dhe te platformes satelitore "****" Sh.a. Duke u ndodhur ne keto rrethana, ka komunikuar me portalin [http:// ***](http://***) dhe ***. Ai deklaroi se ne komunikimin qe ka bere, ka kerkuar sherbimin e transmetimit televiziv te gjithe kanaleve qe operohen kryesisht *** dhe ***. Ne komunikim, i eshte ofruar si sherbim kundrejt pageses prej *** euro abonim nje vjecar. Pasi kane rene ne dakort, ata i kane afruar sherbimin dhe e kane rekomanduar qe pagesen ta bente ne *** me emrin *** me kodin ***. Me pas i eshte ofruar sherbimi dhe transmetimi si me logon e shoqerise *** dhe me logon ne ***. Sh.a. Per kete, ai ka njoftuar Drejtorin Teknik te *** sh.a. ***, duke i derguar ne ẽhats'up dhe madatin e pageses qe kishte bere ne favor te shtetasit ***. Ai deklaroi se ne momentin qe ka marre sherbimin, ne fillim i eshte komunikuar se pagesa do te behet ne emer te shtetasit *** dhe me vone, pas dy tre diteve eshte kontaktuar nga portali qe te ndryshone emrin nga *** ne *** me te njetin kod. Keta shtetas ne cilsine e personave ne hetim, kane bashkepunuar ndermjet tyre me qellim demtimin e interesave financiare te dy kompanive *** dhe ***. Gjithashtu shetasi ***, ka deklaruar se portali qe u ka dhene shtetasi *** eshte *** dhe kete portal ai e ka vendosur ne aparatit *** me adrese *** dhe eshte bere transmetimi i kaneve televizive.

I eshte kerkuar informacion *** ne lidhje me personat qe kane bere terheqjen e pageses se sipershenuar dhe eshte administruar pergjigja nr. *** Prot., date *** dhe pergjigja nr. *** Prot., date ***, i ***, ku rezultoi se transfertat e parave e kryer nepermjet *** me ***, brenda territorit te Republikes se Shqiperise, emri i marresit eshte ***.

Eshte bere sekuestrimi ne origjinal i mandatit te terheqjes se parave me nr. ***, date ***, nga shtetasi ***.

Eshte bere sekuestrimi i aparatit *** adrese ***, nga shtetasi ***. Eshte vendosur kryerja e ekspertimit teknik, eshte administruar akti i ekspertimit teknik i kesaj pajisje.

Sipas aktit teknik nr. *** date ***thuhet: "Paisja e markes *** model ***, ***, objekt

ekspertimi, është një pajisje "IPTV", e cila përveç funksioneve të tjera shërben për marrjen e kanaleve të ndryshme televizive me kualitet të lartë nëpërmjet internetit. Menuja e kësaj pajisje mund të konfigurohet nga specialiste me njohuri të posaçme për të dekoduar dhe për të lidhur me kanale të ndryshme televizive nëpërmjet rrjetit të internetit. Pajisja objekt ekspertimi, në momentin e ndezjes për ekzaminim (e konëktuar me internetin) me datë 06.01.2021, u konstatua se ndizet dhe starton normalisht, si dhe në ekran na shfaqet një menu me emërtimin "Select a portal for lading", e cila përveç të tjerave në rubrikat e saj ka një aplikacion me emërtimin "****" dhe me adresën [http:// ****](http://****). Kjo adresë është konfiguruar që të shfaqet në mënyrë automatike në menunë e saj. Nga analizimi i përmbajtjes së rubrikave të menuse pajisjes objekt ekspertimi, u konstatua se pas përzgjedhjes së rubrikës me emërtimin "****" dhe adresën "[http:// ****](http://****)", në pjesën fundore të ekranit, u shfaqën rubrikat me emërtimet "Media", "TV", "Videoclub", "TV Series", "Radio", "Youtube", "Internet", "Account" dhe "Settings". Nga përzgjedhja e rubrikës me emërtimin "TV", në ekran u shfaq një rubrikë e cila ka emërtimet e shteteve "Albania", "Germany", "Italy", si dhe emrat e disa programeve "Best of Sports", "Best of music", "Best of Lifestyle", "Best of Kids", "Best of Documentary". Pas përzgjedhjes së rubrikës me emërtimin "Albania" u shfaqet një rubrikë tjetër me emërtimin "Tv/Albania/By Number" në të cilën janë listuar disa kanale të platformave televizive shqiptare dhe të platformave televizive të huaja. Gjate përzgjedhjes së disa prej kanaleve që gjenden të listuara në rubrikat e grupit të kanaleve me emërtimet "Albania", "Germany", "Italy", "Best of Sports", "Best of Music", "Best of Lifestyle", "Best of Kids", "Best of Dokumentary", u konstatua se këto kanale televizive në momentin e ekzaminimit (me datë 06.01.2021) janë aktive për tu ndjekur transmetimet e tyre, nëse pajisja është e lidhur me internetin. Nga përzgjedhja dhe leximi (shikimi) i përmbajtjes së disa prej kanaleve televizive shqiptare që gjenden të listuara në rubrikën "Albania" të menuse së pajisjes objekt ekspertimi, dhe konkretisht kanaleve televizive me emërtimet; ***, ***, *****, ***, *****, ***, ***, ***, ***, u konstatua se këto kanale televizive, si dhe disa të tjera në momentin e ekzaminimit, janë të hapura/aktive për tu ndjekur transmetimet e tyre në kohe reale (live) nëse pajisja objekt ekspertimi, është e lidhur me rrjetin e internetit. Në lidhje me këto kanale televizive u konstatua se gjate transmetimit të programeve në logot që shfaqin në ekran, disa prej tyre paraqesin emërtimet e kanaleve dhe një shkronjë në formën "****" si ajo e logos së kanaleve të transmetohen nga platforma "****", ndërsa disa kanale të tjera paraqesin gjithashtu emërtimet e kanaleve dhe një shkronjë në formën si ajo e logos së kanaleve që transmetohen nga platforma "****". Gjate kërkjes së rubrikave të menuse së pajisjes objekt ekspertimi, konstatohet se përveç kanaleve televizive të përshkruara e pasqyruara në pjesën ekzaminative të këtij akti ekspertimi, kjo pajisje nëpërmjet rubrikave të menuse saj, mundeson shikimin e një numri të konsiderueshëm kanalesh televizive të platformave shqiptare dhe të platformave të shteteve të ndryshme. Gjate analizimit të përmbajtjes së rubrikave të menuse së pajisjes objekt ekspertimi, u konstatua se tek rubrika "internet/account/information" gjendet i ruajtur një informacion mbi periudhën kohore se deri kur i ofrohet shërbimi përdoruesit të pajisjes me *** adresën: *** (numri i identifikimit të pajisjes në rrjet) dhe konkretisht shkruhet se "Abonimi mbaron më 24 Shtator 2021 ora 01:58 pm".

I pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime Shtetasi ***, ka deklaruar se me shtetasin *** është shok që në fakultet. Në muajin tetor të vitit 2020, e ka telefonuar *** dhe i ka ka thënë se një shok i ***, kishte nisur një shumë lekesh prej *** euro në emrin tij dhe ***vete, nuk i terhiqte dot dhe i kishte kërkuar atij të bente këto terheqje. Për këto *** i kishte dhënë dhe kodin e ***për terheqjen e kësaj shume. *** pasi ka marrë kodin është paraqitur në piken e *** dhe pas terheqjes së kësaj shume ja ka dhënë shokut tij ***. Shtetasi *** deklaroi se, ka shkarkuar portalin in ***, për të parë televizorin në telefonin e tij dhe kodin ja ka dhënë ***, por aktualisht ai deklaroi se nuk e ka me në telefon as kodin dhe as aplikacionin.

I pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime, shtetasi *** ka deklaruar se duke eksploruar ne internet ka pare faqen e ***. Sipas kesaj faqe, ne internet ofronte blerjen e produkteve qe ishin per rishitje. Ai deklaroi se konkretisht me ane te kartes se kreditit, ka blere *** kredite per vleren *** Euro. Keto kredite ishin sherbim i ofruar, kanale televizive te platformave te ndryshme. Ai deklaroi se sherbimet ketyre kanaleve televizive pasi i ka, blere nga kjo faqe sipas tij, kishte te drejte ti rishiste perseri dhe per kete kete ka hapur nje faqe ne instagram me ernertimin ***, ku me ane te kesaj faqeje ka vendosur kontakte faqe ka vendosur kontaktin me nje shtetas shqiptar te Maqedonise, qe nuk i kujtohet emri i cili i ka kerkuar dy abonime televizive *** por *** i ka derguar nje link te portalit ku sipas tij e ka blere ne faqen ***. Ai deklaroi se shtetasi Maqedonas me ane te aplikacionit E'hats'up i ka derguar foto te aparatit qe dispononte ai qe ishte ***, i cili sherben per marrjen e sinjalit televiziv *** nepermjet internetit. Pas kesaj ***, linkun ketij shtetasi Maqedonas, pasi linku eshte marre nga faqja ***, qe e gjeneron sistemi. Shtetasi *** deklaroi pasi shtetasi Maqedonas ka bere pagesen prej 100 euro, nepermjet *** ai i ka dhene linkun. Bisedat jane bere nepermjet aplikacionit e'hats'up ku fillimisht *** i ka thene atij, qe adresen e parave ta bente nepermjet ***. Ai e ka nisur dergesen e parave ne emerin tij dhe kur ka shkuar per te terhequr parate ne nje pike te kesaj kompanie ne ***, punonjesi i *** i ka thene se ti nuk mund ta terheqesh kete dergese parash pasi dergesa eshte bllokuar nga vete personi qe ka bere dergesen. Ai deklaroi se pas kesaj ka komunikuar perseri me kete shtetas dhe ai i ka thene se meqe nuk i terheq dot ti, me jep nje emer tjetere dhe *** i ka dhene emrin e shokut tij ***, ku ky i fundit eshte paraqitur ne nje pike te *** dhe ka bere terheqjen e dergeses se parave. Pas 4-5 diteve, kur ai eshte takuar me ***, ky i fundit i ka dhene parate. Shtetasi *** ka deklaruar se linku qe i ka derguar personit eshte *** dhe ky link ofron kanale televizive nga e gjithë bota. Ai deklaroi se faqja e instagramit *** ka qene e hapur vetem 5 dite dhe i eshte mbyllur nga vete Instagrami. Shtetasi *** deklaroi se nuk e di se kush e administron faqen ***, nuk e din nese eshte faqe shqiptare apo e huaj. Pagesen e ka bere me karte krediti ose paypal. Dhe nuk e di as numrin e llogarise se kesaj faqe dhe emrin e personit.

Vlerësimi i Gjykatës.

Përsa i përket kualifikimit ligjor të fakteve të parashtruara më sipër Gjykata vëren se, **neni 149/a/2 i K.Penal** parashikohet shprehimisht se

“Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i:

- a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës;*
- b) produktit që mbrohet nga një dizeno industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenos industriale;*
- c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare;*
- ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen megjohë ose me burgim gjer në një vit.*

Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjohë ose me burgim gjer në dy vjet.”

Në lidhje me objektin e veprës penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” parashikuar nga **neni 149/a/2 i K.Penal**, Gjykata thekson se me anë të nenit 149/a/2 të Kodit Penal janë marrë në mbrojtje të posaçme juridike për garantimin e të drejtave të pronësisë

industriale. Veprimet e shtetasve në kundërshtim me këto rregulla janë objekti i këtyre veprave penale dhe pasjellin përgjegjësi penale. Në rastin konkret, ka prova të mjaftueshme se ky objekt është cenuar nga të pandehurit *** dhe ***, pasi me veprimet e tyre të drejtpërdrejta dhe të vullnetshme, veprime të cilat do t'i analizojmë më poshtë në analizë të anës objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale ata kanë shkelur të drejtat e pronësisë industriale.

Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjen rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

Në kuptim të nenit 149/a/2 të Kodit Penal, vepra penale kryhet me anë të prodhimit, shpërndarjes, mbajtjes për qëllime tregëtimi, shitjes, ofrimit për shitje, furnizimit, shpërndares, eksportimit ose importimit për qëllime të parashikuara nga gërmat a) – ç) të nenit 149/a të KP;

Në këtë mënyrë Gjykata arrin në konkluzionin se provohet përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit *** dhe *** kanë konsumuar në tërësi me sjelljen e tyre të kundraligjshme anën objektive të veprës penale të **“Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”** parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal. Nga aktet e administruara ne fashikullin hetimor te ketij procedimi penal rezulton se shtetasi *** dhe *** , ne bashkepunim me njeri-tjetrin, kane konsumuar teresisht elementet e figures se vepres penale te "Shkelja e te drejtave te pronesisë industriale" ne bashkepunim parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal.

Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale. Gjykata vlerëson se, vepra penale e “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” parashikuar nga neni 149/a/2 i Kodit Penal kryhet me dashje. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive. Prandaj, për të përcaktuar anën subjektive në çështjen objekt gjykimi, gjykata do të analizojë veprimet e të pandehurve *** dhe ***. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se provohet përtej çdo dyshimi se të pandehurit, kanë vepruar me dashje të drejtpërdrejtë. Qëllimi parashikuar në dispozitë është element cilësues i veprës penale.

Në lidhje me subjektin e veprës penale, gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohet ky element, duke pasur parasysh nenin 12 të Kodit Penal, ku thuhet se *“Ka përgjegjësi penale*

personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore: Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: “Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale” Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t’i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. **Së pari:** personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. **Së dyti:** ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekuilibrin mendor të personit. **Së treti:** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale.

Në rastin konkret, të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qënë mbi 18 vjeç dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës të pandehurit *** dhe *** , kanë qënë madhor dhe të përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale, objekt gjykimi dhe si të tillë ata kanë patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që të pandehurit të vuajnë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tyre mendor dhe për pasojë nuk kanë qënë në gjëndje të kontrollojnë veprimet apo mosveprimet e tyre dhe as të kuptojnë se kryejnë vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tyre, provohet që ata kanë qënë të aftë të posedojnë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tyre dhe t’u kontrollojnë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se të pandehurit janë subjekt të përgjegjshëm penalisht.

Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit *** dhe *** e kane kryer veprën penale të “**Shkelja e të drejtave të pronesisë industriale**”, parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal dhe duhet të dënohen për këtë vepër.

Akuza në ngarkim të të pandehurve *** dhe *** është provuar në seance gjyqesore me administrimin në teresi të akteve të ndodhura në fashikullin e procedimit penal të cilat pasi u moren për shqyrtim, u administruan në dosje duke zbatuar gjykimin e shkurtuar.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Gjykata para se të disponojë me dënimin penal, duhet të ketë parasysh parimet dhe kriteret e përgjithshme të caktimit të dënimit.

Gjykata vlerëson se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale nga njëra anë dhe shkallës së fajit të autorit të saj nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se individualizimi i llojeve të dënimeve, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar gjithë elementët juridikë të veprës penale,

shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Kështu, neni 47 i tij, nën titullin “Mënyra e caktimit të dënimit”, parashikon se “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.” Në këtë dispozitë është shprehur parimi i individualizimit të dënimit, i cili është një nga parimet themelore që udhëheq gjykatën në caktimin e dënimit. Kjo është arsyeja pse ligjvënësi për çdo vepër penale të veçantë ka parashikuar marzhet minimum dhe maksimum për dënimin e veprës penale. Pikërisht ky limit do të jetë hapësira e gjykatës për të vlerësuar masën e dënimit.

Një nga kriteret që mban parasysh gjykata në caktimin e dënimit është rrezikshmëria e vepres penale, e cila përcaktohet nga këto elemente, që janë: a) Objekti; b) Vendi; c) Koha; d) Gjendja në të cilën kryhet vepra penale; e) Nëse vepra penale është e përhapur në atë rreth; f) Rrethanat që kanë ndikuar në kryerjen e saj.

Në lidhje me rrezikshmërinë e figurës së veprës penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”. Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Gjykata thekson se kjo vepër përbën kundravajtje penale dhe paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimet *e përshkruara më lart*. Prandaj, në caktimin e dënimit gjykata duhet të ketë parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjithashtu, për interpretimin e “rrezikshmërisë së autorit të saj” Gjykata ka parasysh disa elemente të tjerë si: a) Gjendja sociale; b) Profesionin; c) Arsimin; d) Gjendja familjare; e) Gjendja gjyqësore. Interpretuar në harmoni të gjithë këto rrethana objektive dhe subjektive që kanë lidhje të drejtëpëdrejtë me personalitetin dhe individualitetin që paraqet individi në shoqërinë tonë, japin konkluzionin se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët ose të lartë. Prandaj, për gjykatën lind detyrimi që në çdo çështje të analizojë faktorët apo tiparet e personalitetit të autorit të veprës penale. Kjo për faktin, pasi për arritjen e qëllimit të parandalimit të posaçëm është e nevojshme që dënimi t’i përshtatet personalitetit të fajtorit d.m.th t’i përshtatet tërësisë së karakteristikave individuale të tij, që përbëjnë fizionominë e tij politiko shoqërore. I pandehuri nuk është dhe nuk mund të shikohet si figurë abstrakte, por si një njeri i gjallë me cilësi të caktuara, me një të kaluar dhe me një prespektivë të caktuar. Sipas të drejtës tonë penale vepra penale përbën një unitet të elementëve objektiv dhe subjektivë dhe në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës influencojnë në shumë raste rrethanat që karakterizojnë të pandehurin, cilësitë e subjektit të krimit.

Zhvillimi mendor, karakteri dhe gjendja e ndërgjegjes së autorit kanë rëndësi për trajtimin penal të saj. Në çmuarjen e personalitetit të të pandehurit duhet të merret parasysh mosha si tregues kryesor i pjekurisë mendore, sjellja e tij e mëparshme, sjellja pas kryerjes së veprës penale, pendimi dhe gadishmëria për të riparuar pasojat e veprës penale. Gjithashtu, duke u nisur nga këto tipare, duhet konstatuar se çfarë përfaqëson për të pandehurin vepra penale që ai ka kryer, është ajo pasojë llogjike e botkuptimit, karakterit dhe prirjeve apo ajo nuk përfaqëson thelbin e cilësive dhe tipareve të tij, por është një akt i pamenduar mirë, një

reagim në rrethana konkrete të rastit. Prandaj, në çdo çështje konkrete, gjykata, duhet të hetojë lidhur me personalitetin e të gjykuarit. Kjo për faktin pasi mënyra e reagimit të autorëve ndaj dënimit ose ndikimi që mund të ushtrohet mbi këtë me anë të dënimit është i ndryshëm.

Në lidhje me këtë kriter, për të pandehurin ***, Gjykata në rastin konkret mban parasysht disa fakte. Së pari: personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, ku nga vërtetimi mbi gjendjen gjyqësore rezulton se i pandehuri është i padenuar. Së dyti, gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezulton të jetë beqar. Së treti, moshën e të pandehurit i vitlindjes ***, Së katërti, arsimin e të pandehurit, i cili deklaron se është me arsim të lartë.

Në lidhje me këtë kriter, për të pandehurin ***, Gjykata në rastin konkret mban parasysht disa fakte. Së pari: personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, ku nga vërtetimi mbi gjendjen gjyqësore rezulton se i pandehuri është i padenuar. Së dyti, gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezulton të jetë beqar. Së treti, moshën e të pandehurit i vitlindjes ***, Së katërti, arsimin e të pandehurit, i cili deklaron se është me arsim të lartë.

Shkallën e fajit. Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurve, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit, pasi ata ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tyre dhe kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme.

Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në caktimin e masës së dënimit kundër autorëve të vepërës penale penale konkrete, gjykata mban parasysht, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektivë që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Gjykata, në çështjen objekt gjykimi mban parasysht faktin që ndaj të pandehurve nuk konstatohet asnjë rrethanë rënduese nga ato të parashikuara nga neni 50 të Kodit Penal.

Sa më sipër, duke analizuar në kompleksitet të gjitha rrethanat e përmendura më sipër, Gjykata çmon se, të pandehurit paraqesin rrezikshmëri shoqërore të tillë, e cila e bën të nevojshme dhe të domosdoshme që gjykata të japë një masë dënimi me gjobë ndaj tyre. Për rrjedhojë, mbështetur në nenet 47-50 të Kodit Penal Gjykata çmon se, i pandehuri *** duhet të dënohet me *** **lekë gjobe** per kryerjen e vepres penale te “**Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale**”, parashikuar nga **neni 149/a/2 i Kodit Penal** dhe ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe e denon perfundimisht të pandehurin *** **me *** lekë gjobë**. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanave të kryerjes dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret. Gjoha te paguhet brenda 6 (gjashte) muajve nga dita qe vendimi merr forme te prere. Mbështetur në nenet 47-50 të Kodit Penal Gjykata çmon se, i pandehuri *** duhet të dënohet me *** **lekë gjobe** per kryerjen e vepres penale te “**Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale**”, parashikuar nga **neni 149/a/2 i Kodit Penal** dhe ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe e denon perfundimisht të pandehurin *** **me *** lekë gjobë**. Gjykata çmon se, dënimi i mësipërm është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale, rrethanave të kryerjes dhe rrezikshmërinë e autorit në rastin konkret. Gjoha te paguhet brenda 6 (gjashte) muajve nga dita qe vendimi merr forme te prere.

Duke qenë se të pandehurit *** dhe *** u deklaruan fajtorë dhe u dënuan për veprën penale për të cilën akuzohen, bazuar në nenet 393 e 485 të K.Pr.Penale, të pandehurit detyrohen të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet proceduriale të kryera në fazën e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar të nenet 384 e 390 te Kodit të Procedurës Penale

V E N D O S I

- 1) Deklarimin fajtor të të pandehurit *** për veprën penale të “**Shkelje e te drejtave te pronesise industriale**” dhe në bazë të nenit **149/a/2 të K.Penal** dënimin e tij me *** **lekë gjobe.**
- 2) Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht **të pandehurin *** me *** lekë gjobë.**
- 3) Gjoha te paguhet brenda 6 (gjashte) muajve nga dita qe vendimi merr forme te prere.
- 4) Deklarimin fajtor të të pandehurit *** për veprën penale të “**Shkelje e te drejtave te pronesise industriale**” dhe në bazë të nenit **149/a/2 të K.Penal** dënimin e tij me *** **lekë gjobe.**
- 5) Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht **të pandehurin *** me *** lekë gjobë.**
- 6) Gjoha të paguhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita që vendimi merr formë të prerë.
- 7) Shpenzimet e kryera gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore në ngarkim të të pandehurve në mënyrë solidare.
- 8) Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tirane sot me **datë 04.11.2021.**

SEKRETAR

GJYQTAR

REI

PEÇI

LAZER SALLAKU

Shpenzime gjyqësore

Shpenzime proceduriale te prokurorise Nuk ka te evidentuara.

Shpenzime te gjykimit ne seance paraprake 450 Leke.

Shpenzime te gjykimit ne themel 300 Leke